KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
622-25-566-2-1-1/C1612

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Qemal Krasniqi B.I., Saraqet 59/A, Prizren, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit. projekt trevjeqar me numër identifikues: **622-25-566-2-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit. projekt trevjeqar

Nr.	*Grupi*
1	**Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit. projekt trevjeqar**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performophen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 18. 04. 2025 dhe përfundon në datën 17. 04. 2028

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **Territori i Komunës së Prizrenit.**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **1,424,175.00 € (një milion e katërqind e njëzet e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pes euro)**. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është + - 30 % nga vlera e përgjithshme e kontratës bazë.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kontrata Publike Kornizë;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
(f) Urdhër blerja;
(g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit]*.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet [1] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

[1] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	**Isa Osmankaj**
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	16.04.2025
Vula:	

[Ne rast te kontratave me vlere te madhe]

Emri:	**Z. Shaqir Totaj Kryetar**
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	23.04.25
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Dimlind Krasniqi
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	25.04.2025
Vula:	Ndërmarrja Tregëtare Punuese Ndërtimore KRASNIQI Qemal Krasniqi B.I. Prizren

KUSHTET E VEÇANTA

622-25-566-2-1-1/C1612

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë **gjuha Shqipe.**
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është ***dy dit pas nënshkrim it të kontratës.***
	6.4	Data e Përfundimit është **36 muaj kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës**
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është *territori i Komunës së Prizrenit*
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	**Mbikqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit do të jetë ; Çelë Lamaj Drejtor në DSHP** **Menaxheri i Projektit është Ejup Kryeziu IDN *në DSHP***
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është **0.25% e Çmimit final të Kontratës** në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është **10%** të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është **10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 37 muaj kalendarik.**
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Përgjegjësia e Palës së Tretë *[shëno shumën]* b) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve *[shëno shumën]* c) Përgjegjësia profesionale *[shëno shumën]* d) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës *[shëno shumën]*
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues
Kontrolli i	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti

kualitetit		kontraktues do të jenë si në vijim: *[shëno]* Periudha Garantuese e Defekteve është *[shëno datën]*
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	**Neni 42** 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
		43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	**Neni 42** 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
		43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRE Rr. Remzi Ademaj. -20000. PRIZREN.

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-25-566-2-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Qemal Krasniqi B.I., Saraqet 59/A. 20000. Prizren. Kosovë**

E-mail: **ntpnkrasniqi@hotmail.com**

Personi kontaktues: **Dimlind Krasniqi**

Telefoni: +38349647177

Faxi:

Numri fiskal: **811284629**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-25-566-2-1-1

Titulli i kontratës: Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit, projekt trevjeqar

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 **Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit, projekt trevjeqar**

3. Çmimi total i tenderit është:

1,424,175.00 EUR

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë* ***Euro***]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjeses, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqesit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

PARAMASA PËR PASTRIMIN DHE ZHBLLOKIMIN E KANALIZIMEVE, UJËMBLEDHËSAVE DHE PUSETAVE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali (€)
1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve. Në çmim të llogaritet kosto e përpilmit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kostoja e transportit të makinave dhe stafit punues në vendet ku do të intervenohet në pastrimin e kanalizimit dhe pusetave në territorin e Komunës.	copë	750	30.00 €	22,500.00 €
2	Sigurimi i vendpunishtes me mjete sinjalizuese për punime në rrugë,sigurim të komunikacionit (semafora me energji solare, semarora me drita 3.5 kw) , shiriti sinjalizues etj.	copë	750	20.00 €	15,000.00 €
3	Pastrimi dhe zhbllokimi i kanalizimeve me autocistern-Kamion adekuat për kanalizime, për të gjitha profilet e gypave, nga Betoni (në disa vende gypat janë të mbushur me zhavor dhe janë shumë pak funksionale, sidomos gypat me diametër Ø 1000mm dhe Ø800m) Kamioni i pastrimit të gypave dhe pusetave duhet të posedoj: - pompë vakumi për thithjen e llumrave të fekaleve, dhe ujërave atmosferike, si: zhavor dhe fekale e gjësende tjera.				
3.1	Pastrimi i gypit të betonit Ø1000mm	m'	1200	3.50 €	4,200.00 €
3.2	Pastrimi i gypit të betonit Ø800mm	m'	2200	3.50 €	7,700.00 €
3.3	Pastrimi i gypit të betonit Ø600mm	m'	3000	4.50 €	13,500.00 €
3.4	Pastrimi i gypit të betonit Ø500mm	m'	3500	4.30 €	15,050.00 €
3.5	Pastrimi i gypit të betonit Ø400mm	m'	9500	4.00 €	38,000.00 €
3.6	Pastrimi i gypit të betonit Ø300mm	m'	10000	4.00 €	40,000.00 €
4	Pastrimi dhe zhbllokimi i kanalizimeve me autocistern-Kamion adekuat për kanalizime, për të gjitha profilet e gypave, nga HDPE (në disa vende gypat janë të mbushur me zhavor dhe janë shumë pak funksionale)				
4.1	Pastrimi i gypit HDPE Ø630mm	m'	100	4.00 €	400.00 €
4.2	Pastrimi i gypit HDPE Ø500mm	m'	1500	4.00 €	6,000.00 €
4.3	Pastrimi i gypit HDPE Ø400mm	m'	4000	4.00 €	16,000.00 €
4.4	Pastrimi i gypit HDPE Ø315mm	m'	8000	4.00 €	32,000.00 €
4.5	Pastrimi i gypit HDPE Ø250mm	m'	7000	4.00 €	28,000.00 €
4.6	Pastrimi i gypit HDPE Ø100mm deri Ø200	m'	3300	3.50 €	11,550.00 €
5	Pastrimi i pusetave të kanalizimeve fekale dhe atmosferike, thellësia nga 1 m deri 6.50 m. Me dimensione të gjërësisë së ndryshme (Ø1000x600 deri Ø1000x1200)	copë	9585	55.00 €	527,175.00 €
6	Largimi dhe transporti i ujërave fekale me kamion deri në vend të caktuar - deponi. Në largësi 10 - 30 km.	m³	20500	0.80 €	16,400.00 €
7	Pastrimi dhe largimi i gjësendeve të ndryshme të cilat ndodhen në kanal (lecka të ndryshme, zhavor dhe mbjetje tjera). Transporti deri në vende të caktuar- deponi. Në largësi 10-30 km.	m³	12000	0.80 €	9,600.00 €

Ndërmarrja Tregëtare Punuese Ndërtimore KRASNIQI Qemal Krasniqi S.H.P. Prizren

8	Pastrimi i ujërave dhe largimi i mbetjeve (balta, llumra) nga të rreshurat atmosferike, që në disa raste gjatë vërshimeve ujërat e përziera vërshojnë bodrumet e ndërtesave të ndryshme, shtëpi, oborre, rrugë, lokale dhe objekte institucionale. **Vërejtje: OE është i obliguar që në këto raste emergjente të jetë në dispozicion 24 orë me makineri adekuate për pastrimin e ujërave dhe gjësendeve tjera.**	orë/pune	1100	30.00 €	33,000.00 €	✓
9	Pastrimi me ujë i vendeve dhe rrugëve para dhe pas punimeve, aty ku janë derdhur fekalet, zhavori, etj. Pastrimi duhet të bëhet me kamionë adekuat që ka presion (shtypje) dhe fshisë të pastrimit.	orë/pune	750	30.00 €	22,500.00 €	✓
10	Pastrimi i rrugëve nga të rreshurat e borës gjatë sezonës së dimrit, për të mundësuar që makineria e pastrimit të kanaleve të arrijë në vendin ku është paraqitur nevoja, per pastrimin dhe zhbllokimin e rrjetit te kanalizimeve apo pusetave.	orë/pune	120	55.00 €	6,600.00 €	✓
11	Pastrimi i ujëmbledhësave dhe gypave nga ujëmbledhësi deri në puset me makinë adekuate dhe me dorë. **Vërejtje: Shumica e ujëmbledhësat janë të mbushur me zhavor, në disa raste në pamundësi që të pastrohen me makineri adekuate, ato duhet të pastrohen me vegla punë dore.**	copë	8300	47.00 €	390,100.00 €	✓
12	Furnizimi dhe punimi i ujëmbledhëseve prej metali me peshë prej 5 ton deri 40 ton sipas nevojës në terren. (Në çmim të llogaritet materialet e nevojshme deri në finalizimin e punimeve).					
12.1	Furnzimi dhe punimi i ujembledhesit 5-10 ton	copë	120	20.00 €	2,400.00 €	✓
12.2	Furnzimi dhe punimi i ujembledhesit 15-25 ton	copë	130	40.00 €	5,200.00 €	✓
12.3	Furnzimi dhe punimi i ujembledhesit 30-40ton	copë	160	60.00 €	9,600.00 €	✓
13	Furnizim, transporti, vendosja dhe punimi i grillave gjatësore	m'	70	20.00 €	1,400.00 €	✓
14	Thyerja e betonëve në puseta, ujëmbledhësa, gropa septike, kolektorë etj.	m^3	225	50.00 €	11,250.00 €	✓
15	Furnizimi me gypa dhe konus për puseta Ø800-Ø1000mm (aty ku janë të dëmtuara të zëvendesohen), dhe riparimi i pusetave ekzistuese me beton, si dhe rregullimi i kinetave dhe nivelizimi i tyre. Në çmim të parashihen të gjitha materialet dhe punimet e nevojshme.	copë	400	80.00 €	32,000.00 €	✓
16	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej metali. Në çmim të parashihen të gjitha punimet për vendosjen e kapakut dhe materialit për finalizimin e punimeve. Pra, betonimi dhe punët tjera të nevojshme					
16.1	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej metali 10 -15 ton	copë	30	50.00 €	1,500.00 €	✓
16.2	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej metali 20 -30 ton	copë	120	90.00 €	10,800.00 €	✓
16.3	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej metali 40 ton	copë	150	130.00 €	19,500.00 €	✓
17	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej betoni. Në çmim të parashihen të gjitha punimet për vendosjen e kapakut. Pra, betonimi dhe punët tjera të nevojshme					
17.1	Kapak betoni me dimensione 1000x1000mm	copë	120	30.00 €	3,600.00 €	✓
17.2	Kapak betoni me dimensione 800x1000mm	copë	370	20.00 €	7,400.00 €	✓

Ndërmarrja Tregtare
Publike Ndërtimore
KRASNIQI
Q.m.th. Prizren

17.3	Kapak betoni me dimensione 600x800mm	copë	250	15.00 €	3,750.00 €
18	Furnizimi dhe punimi i kapakave prej metali për elektrik,telefoni me peshë të rënda. (Në çmim të llogaritet materialet e nevojshme deri në finalizimin e vendosjes së kapakut)				
18.1	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej 20-30 ton	copë	50	70.00 €	3,500.00 €
18.2	Furnizimi dhe punimi i kapakut të ri prej 40 ton	copë	50	80.00 €	4,000.00 €
19	Pastrimi me dorë i pusetave ekzistuese, dhe kanalizimit nga gurët, copa betoni, kapak të thyer metalik, kapak të thyer betoni dhe gjëra tjera.	orë/pune	350	20.00 €	7,000.00 €
20	Gjatë punimeve të pastrimit, mund të dëmtohen gypat ekzistues, paraqitet nevoja për sanime dhe riparime të gypave të kanalizimit dhe të ujësjellësit të dimensioneve të ndryshme si dhe vendosja e pjesëve tjera fazonike aty ku paraqitet nevoja.	m'	1500	20.00 €	30,000.00 €
21	Demolimi i pjesës ku do të ekzekutohet sanimi deri te pika kritike për sanim. Në çmim të llogariten: demolimet e pllakave betonarme, shtresave të asfaltit, skajoreve, si dhe të gjitha materialeve tjera inerte, dhe transportin e tyre deri në deponi.	m²	550	20.00 €	11,000.00 €
22	Mbulimi dhe planifikimi i hapësirës rrethe pusetës me material gurore të pastër të fraksionuar për mbushje (0-16)mm dhe (0-32)mm, si dhe ngjeshja e tij.	m³	250	20.00 €	5,000.00 €
				Totali me TVSH:	1,424,175.00 €

Ndërmarrja Tregëtare
Punuese Ndërtimore
KRASNIQI
Qendra Krasniqi B.I.
Prizren

PRISIG
KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

POLICË SIGURIMI
INSURANCE POLICY

Sigurimi për Garanci
Guarantee Insurance

Seria | 10001201357

Për

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

Titulli Title	Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit, projekt trevjeqar
Emri i Ofertuesit Name of the Bidder	Qemal Krasniqi B.I.
Adresa Address	Saraqëve 59/A
Telefon Telephone	044306826
Numri i personal / biznesit Personal / business number	811284629
Data e lëshimit Date of issue	16.04.2025
Numri i prokurimit Procurement number	622-25-566-2-1-1
Lloji i kontratës Contract type	Garanci Kontrate

Prej From	16.04.2025
Deri To	16.05.2028
Shuma e sigurimit Insured sum	142,417.50 €
Primi Premium	7,904.17 €
TVSH VAT	1,422.75 €
Totali për pagesë Total for payment	9,326.92 €

AUTORITETI KONTRAKTUES

Numri personal / biznesit Personal / business number	0000
Adresa Address	Remzi Ademaj
Vendi City	Prizren
Telefon Telephone	03820044704

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se pohimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nëqofëse ka fshehje apo shtrembërim të fakteve, unë heqë dorë nga dëmshpërblimi në rast dëmi. Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje më me Ligjin nr.05/L-096 si dhe Nenin 9 të Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të Bankës Qendrore të Kosovës

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage. The police officer declares that the origin of the funds is in accordance with Law no. 05/ L-096 as well as Article 9 of the Regulation on the prevention of money laundering and terrorist financing of the Central Bank of Kosovo

Agjenti

Hysni Gashi

KOMPANIA E SIGURIMEVE - PRISIG - SHOQËRI AKSIONARE

PRISIG
KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

POLICË SIGURIMI
INSURANCE POLICY

Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Seria | 10001201357

Për

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

Qemal Krasniqi B.I.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit, projekt trevjeçar

të dhënë me numrin e Prokurimt

622-25-566-2-1-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoritieti Kontraktues;
DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;
DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:
PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

142,417.50 €	Një Qind e Katërdhjetë e Dy Mije e Katër Qind e Shtatëmbëdhjetë Euro e Pesëdhjetë Cent

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- **Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose**
- **Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm te Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose**
- **Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose**
- **Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të githa shumat brenda limiteve të**

142,417.50 €

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës	16.04.2025	**deri më**	16.05.2028
Lëshuar në	Prishtinë	**datë**	16.04.2025
Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit			

PRISHTINË

KOMPANIA E SIGURIMEVE - PRISIG - SHOQËRI AKSIONARE